



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen

e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr.05.

Prishtinë, më 30.10.2017, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Albulena Haxhiu, Hajdar Beqa, Korab Sejdiu, Bahrim Shabani, Shkumbin Demaliaj dhe Bilall Sherifi.

Munguan: Glauk Konjufca, Sami Kurteshi, Jelena Bontiq, Arben Gashi dhe Agim Aliu.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Blerim Isufaj-KPK, Shaip Havolli-AKK, Ramadan Gashi-ANJF, Florije Kika-AKKVP, Valon Kurtaj-Akademia e Drejtësisë, Lulzim Beqiri-MD, Ramadan Bytyqi-MD, Enis Halimi-KQZ, Miradije Meha-KQZ, Lavdim Krasniqi-SKPK, Sanije Berisha-OSCE, Ardian Bajraktari-MD, Besim Morina-Akademia e Drejtësisë, Arben Ibrahimaj-AKKVP, Nehat Idrizi-KGJK, Vehbi Behluli-KGJK, Ilaz Papaj-KGJK, Drita Vitia-Radio Kosova.

Mbledhjen e kryesoi, Albulena Haxhiu, kryetare e Komisionit.

Rendi i dites:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Diskutim lidhur me buxhetin e Institucioneve/Agjencioneve që bien në fushëveprim të Komisionit për Legjislacion;
3. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Albulena Haxhiu-propozoi që si pikë e parë e rendit të përfshihet:

Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit funksional për Projektligjin nr. 06/L-002, për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2017

Rendi i ditës u miratua me ndryshimet e propozuara.

1. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit funksional për Projektligjin nr. 06/L-002, për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2017

Albulena Haxhiu - hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës dhe kërkoi nga anëtarët e Komisionit të deklarohen nëse kanë vërejtje në projektligj apo amendamentet e propozuara.

Meqë nuk kishte vërejtje, *Komisioni me pesë(5) vota për dhe një (1) abstenim (Albulena Haxhiu) nxori këtë:*

REKOMANDIM

1. Projektligji nr. 06/L-002, për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2017 dhe amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund t'i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

2. Diskutim lidhur me buxhetin e Institucioneve/Agjencioneve që bien në fushëveprim të Komisionit për Legjislacion;

Albulena Haxhiu-në fjalën e saj para përfaqësuesve të institucioneve të pavarura të cilat bien në fushëveprimin e Komisionit për Legjislacion tha se nga Komisioni për Legjislacion do të bëhet përpjekje që kërkesat tuaja buxhetore që do të paraqiten para Komisionit të miratohen edhe në seancë plenare.

Në vazhdim ajo kerkoi nga të gjithë përfaqësuesit e Agjencioneve të pavarura që në pika të shkurtëra të paraqesin para Komisionit kërkesat e tyre buxhetore dhe gjithashtu kërkoi që të njëjtat të dërgohen edhe me shkrim.

Më pas fjalën u'a kaloi përfaqësuesve me radhë si :Lulzim Beqiri-Ministria e Drejtësisë, Nehat Idrizi-Këshilli Gjyqësor i Kosovës,Blerim Isufaj-Këshilli Prokurorial i Kosovës,Ramadan Gashi-Agjencia për Ndihmë Juridike Falas,Floriqe Kika-Agjencioni Kosovar për Krahsim dhe Verifikim të Pronës,Shaip Havolli-Agjencioni Kundër Korrupsion,Valon Myrtaj-Akademia e Drejtësisë dhe Enis Halimi-Komisioni Qendror Zgjedhor, të cilët paraqitën para Komisionit për Legjislacion kërkesat buxhetore dhe kërkuar njëkohësisht përkrahjen e Komisionit për realizimin e këtyre kërkesave.

Pas diskutimeve Komisioni, nxori këtë:

V e n d i m

Për formimin e grupit të punës për shqyrtimin e kërkesave buxhetore të Institucioneve/Agjencioneve që bien në fushëveprim të Komisionit për Legjislacion

Formohet Grupi i punës për shqyrtimin e kërkesave buxhetore në përbërje:

Korab Sejdiu - kryesues,
Hajdar Beqa – anëtar, dhe
Albulena Haxhiu - anëtare

3. Të ndryshme;

Në këtë pikë të rendit të ditës nuk kishte diskutim.

Mbledhja përfundoi në orën 15:10

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Albulena Haxhiu